



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Departamenti Turizmit/ Department of Tourism/ Departman Turizma

KONKURS PUBLIK PËR DIZAJNIMIN E SIMBOLIT SHTETËROR DHE FORMAVE TJERA TË KOMUNIKIMIT TË BRENDIT SË TURIZMIT TË KOSOVËS

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) shpall konkurs publik për dizajnimin e simbolit shtetëror dhe formave tjera të komunikimit të brendit të turizmit të Kosovës,

Data e fundit për aplikim është: 17.08.2023.

Më poshtë gjeni detajet tjera për aplikim:

Me qëllim të ngritjes promovimit të turizmit dhe ngritjes së imazhit për Kosovën nga turistët ndërkombëtar në kuadër aktiviteteve zhvillimore për brendimin e turizmit të Kosovës, , Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, shpall konkurs publik për dizajnimin e simbolit shtetëror dhe formave tjera të komunikimit të brendit të turizmit të Kosovës, i përcaktuar me Ligjin e Turizmit LIGJI NR. 08/L-074:

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

FUSHA E PUNËS:

Duke u bazuar në Hulumtimin për Brendin e Turizmit të Kosovës dhe udhëzuesin për brendin e turizmit synohet të bëhet dizajnimi i simbolit të brendit bashkë me sloganin, të dedikuar dhe për t'u adaptuar edhe në aspekte të tjera të kampanjave digjitale (d.m.th., faqet e internetit, Facebook, Twitter, Instagram, YouTube, Tik Tok) si dhe për materialet e ndryshme të printuara (Broshura, Roll Up, fletushka etj).

Kriteret e dizajnit të simbolit:

- Të jetë origjinal, unik dhe të mos jetë imitim i ndonjë simboli ekzistues.
- Të jetë i veçantë, kreativ, kualitativ, profesional dhe prezantues;
- Të ketë pasqyrim atraktiv të turizmit të Kosovës;
- Të jetë dinjitoz për identitetin më të lartë të turizmit në vend;
- Të jetë lehtësisht i kuptueshëm;
- Të përçojë mesazh të qartë;
- Të jetë i dallueshëm, t'i rezistojë kohës dhe të jetë i lehtë për t'u mbajtur në mend;
- Të jetë i përshtatshëm për vendosje në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, i lehtë për shtyp, në sfonde të bardha dhe të errëta;
- Të jetë lehtë i përdorshëm në madhësi të ndryshme;
- Të ketë shpjegim të secilit detaj të propozuar në simbol

Elementet specifike dhe tematika:

- Simboli duhet të ketë fjalën “Kosova” që duhet të ketë prezencë dominuese për nga madhësia dhe të prezanton brendin e turizmit të Kosoves. Ndërsa teksti i sloganit vendoset si fjali poshtë tekstit “Kosova” me një madhësi të shkronjave shumë më të vogla.
- Ngjyrat bazë janë: e kaltërta e Kosovës dhe e bardha si ngjyrat kryesore të simbolit. E kuqja dhe e gjelbërta mund të përdoren shtesë
- Tema e ngjyrave dhe dizajnit: mundësisht ngjyra të heshtura – me ndjesi natyrale;
- Tipografia: zyrtare e qeverisë
- Stili i tekstit: ngjyra të mprehtë për tekstin dhe ngjyra të heshtura për sfondin;
- Tema e simbolit/logos: Mali, trashëgimia kulturore dhe populli (miqësor) i Kosovës duhet të jenë elementet kryesore të simbolit
- Stili i ilustrimit të simbolit/logos: Minimal i sheshtë për pamje të freskët dhe moderne
- Në aspektin emocional të krijon: ndjesi pozitive, energjike dhe atraktive.

Slogani i turizmit:

Brendimi i turizmit të Kosovës duhet ta pozicionojë Kosovën si një destinacion turistik që është mikpritës, argëtues, i sigurt, miqësor, i gjelbërt, i pasur dhe unik në histori dhe trashëgimi kulturore. Prandaj slogani duhet të përmbaj këto elemente në një fjali të vetme. Slogani duhet të jetë i shkurtër dhe në gjuhën angleze. Mund të paraqiten deri në tri slogane. Slogani do të prezantohet si pjesë përbërëse e simbolit shtetëror të turizmit.

Mënyra e aplikimit:

Dizajnimi i simbolit duhet të dorëzohet i printuar në pliko të mbyllura me shifër dhe pa emër të autorit dhe i njëjti edhe në CD, (në të kundërtën do të skualifikohet), në formën elektronike sipas verzionit vektor duke përfshirë variacionet e sloganit, tipografinë, shabllonet (templates), produktet përkatëse të komunikimit.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë një manual të shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit të simbolit dhe sloganit.

Dosja e aplikimit duhet të ketë mbishkrimin "Për dizajnin ideor të simbolit shtetëror të turizmit të Kosovës"

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Lagjja e Spitalit, rr."Arbënor e Astrit Dehari", nr. 21
10000 - Prishtinë/ Republika e Kosovës.

Kush mund të konkurrojë:

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë dizajnerët ose artistët nga Kosova, rajoni dhe bota.

Konkursi është i natyrës garuese. Komisioni vlerësues do të zgjedhë tre fitues, çmimin e parë, çmimin e dytë dhe çmimin e tretë.

- çmimi i parë 5,000 Euro
- çmimi i dytë 2,000 Euro
- çmimi i tretë 1,000 Euro

Të drejtat e autorit për propozimet e përzgjedhura barten nga propozuesi tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.